




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivered	24.12.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	6329	2021	1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.937/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësës, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.937/2021 të datës 17.11.2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë Drejtoria e Inspektoratit, Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "kompensim material", kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 24.12.2021, mori këtë

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.937/2021 e datës 17.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Kamenicës sipas Akt emërimit me numër 02/503/59 të datës 15.09.2011 në vendin e punës "Inspektor i Tregut" në Sektorin e Inspektoratit, me datë 19.02.2021 me numër 4269 ankuesi ka parashtruar kërkesë për nivelizim të pagës tek Kryetari i Komunës së Kamenicës, Nënkyetarët e Komunës dhe tek Menaxheri i Personelit të Komunës së Kamenicës.

Ankuesi pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij të datës 19.02.2021 me numër 4269, me datë 06.10.2021 parashtron ankesën me numër 30416 me pretendim për nivelizim të pagës në Komisionin komunal për ankesa për drejtat personale dhe çështje juridike, i cili Komision nuk i kthen përgjigje lidhur me ankesën e tij, pasi që organi të punësimit nuk i kthen përgjigje ankuesit lidhur me kërkesat e tij, ankuesi me datë 15.11.2021 parashtron ankesë nëpërmjet Postës së Republikës së Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 17.11.2021 me numër të protokollit 5488/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 19.11.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Kamenicës. Këshilli më datë 09.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/6.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 17.11.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 15.09.2011; Kërkesa e datës 19.02.2021 për nivelizim të pagës; Përshkrimi i detyrave të punës për vendin e punës "Inspektor i Tregut"; Kërkesë për ngritje të koeficientit e datës 30.12.2020; Ankesa e datës 05.10.2021 e parashtruar në Komisionin Komunal për ankesa për drejta personale dhe çështje juridike; Lista e pagave për muajin nëntor 2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *jashtëafatshme, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 19.02.2021 me numër 4269 ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit me pretendim ankimor për nivelizim të pagës, më tutje ankuesi pretendon se me kolegët ka dorëzuar letër qarkore e protokolluar me numër 31058 e datës 30.12.2020 për të cilën nuk ka marrë përgjigje edhe pse afati i paraparë ka kaluar, arsyeja e kërkesës sipas ankuesit është se nuk është në të njëjtën pozicion si kolegët e tij ku disa kanë koeficientë tetë (8) e disa te tjerë shtatë pikë pesë (7.5) ndërsa vetëm ky si inspektor ka koeficient gjashtë (6) edhe pse punët të cilat i kryejnë janë të njëjta.

Ankuesi i pa kënaqur me mos marrjen e përgjigjeve lidhur me kërkesat e tij tek organi i punësimit, me datë 15.11.2021 nëpërmjet Postës së Republikës së Kosovës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 17.11.2021 me numër të protokollit 5488/2021 me pretendim ankimor që ta shqyrtoj ankesën e tij Këshilli konform ligjeve në fuqi duke u bazuar në nenin 43, 44 si dhe nenit 50 të Ligjit për Shërbimin Civil Nr.03/L-149 dhe kërkon nga Këshilli që ti aprovohet ankesa e tij bazuar në ligj kështu duke e detyruar shërbimin e personelit të Komunës së Kamenicës që të bëjë ngritje të koeficientit nga gjashtë (6) në tetë (8).

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 125 paragrafi 1 përcakton se: *"1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: heshtja administrative)"* pastaj me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 i po këtij ligji ka përcaktuar se: *"Ankesa kundrejt*

heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmimeve të ofruara ka konstatuar se ankuesi kërkesën për nivelizim të pagës e ka filluar me kërkesën e datës 19.02.2021 me numër 4269, ndërsa ankesën me numër protokoll 5488/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar me datën 15.11.2021 nëpërmjet Postës së Republikës së Kosovës të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 17.11.2021, andaj Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 17.11.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”*, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit kundër heshtjes administrative brenda afatit prej dy (2) muajsh për parashtrimin e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.937/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

